

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKTA E APELIT E KOSOVËS- Departamenti për Krime të Rënda, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët, Tonka Berishaj kryetare e kolegjit, Have Haliti dhe Fillim Skoro, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Përparim Zeka, si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të akuzuarve H.G. nga fsh. ..., Komuna e Skenderajit dhe L.K. nga fsh. ... Komuna e Skenderajit, për shkak të veprës penale, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 e lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe të akuzuarve H.S. nga fsh. ..., Komuna e Skenderajit, V.J. nga Skenderaji dhe N.H. nga fsh. ..., Komuna e Skenderajit, për shkak të veprës penale, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesave të Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë, mbrojtësve të akuzuarve H.G., av. G.H. e L.K., av. Q.R., si dhe përgjigjes në ankesë të akuzuarve H.S. dhe N.H., të paraqitur kundër aktgjykimi të Gjykatës Themelore-DRK në Mitrovicë, P.nr.77/2016 të datë 29.10.2017, në seancën e kolegjit të mbajtur, konform nenit 390 par.1 të KPPK- së, me datë 06.04.2018, mori këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pa bazuara, ankesat e mbrojtësve të akuzuarve H.G. dhe L.K., si dhe ankesa e Prokurorisë Themelore DKR në Mitrovicë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-DKR, P.nr.77/2016 të datë 29.10.2017, vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë-DRK, P.nr.77/2016 të datë 29.10.2017, të akuzuarit H.G. dhe L.K., janë shpallur fajtorë për veprat penale, keqpërdorim i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 e lidhur me nenin 81 të KPRK-së, dhe janë gjykuar: i akuzuari H.G. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 6 (gjashtë) muaj, i akuzuari L.K. me dënim me burgim në kohëzgjatje prej nga 6 (gjashtë) muaj, i cili dënim me pëlqimin e të akuzuarve iu është zëvendësuar me dënim me gjobë në shumë prej nga 1.800 €,

secilit veç e veç, të cilën gjobë janë obliguar ta paguajnë në afat prej 3 (tre) muajve, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Nëse të akuzuarit nuk mund ta paguajnë dënimin me gjobë, gjykata mund t'iu zëvendësojë dënimin me gjobë në dënim me burgim, ashtu që për një ditë burgim do t'iu llogaritet shuma prej 20 €.

Të akuzuarit i ka obliguar që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të gjykatës, kurse në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 50 €, secili veç e veç, në afat prej 15 ditëve, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të akuzuarit H.S., V.J. dhe N.H., konform nenit 364 par. 1 pika 1. 3 të KPPK-së, janë liruar nga aktakuza, për shkak të veprës penale, keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par. 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, meqë nuk është provuar se e kanë kryer veprën penale e cila ju vihet në barrë.

Shpenzimet e procedurës penale për këta të akuzuar bien në barrë të mjeteve buxhetore të gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë paraqitur:

Prokuroria Themelore DKR në Mitrovicë, për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal, sa i përket pjesës liruese të aktgjykimit për të akuzuarin H.S., V.J. dhe N.H., me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe lënda të kthehet në rigjykim, ndërsa për të akuzuarin H.G. e L.K. për shkak të vendimit mbi dënim me propozim që të njëjtëve të iu shqiptohet dënim më i ashpër.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.G. av. G.H., për shkak të shkeljes së ligjit penal, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendje faktike dhe vendimit mbi dënimin, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të priset dhe lënda të kthehet në rigjykim dhe rivendosje.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.K. av. Q.R., për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimi të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që aktgjykimi i ankimuar të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim apo të ndryshohet dhe i akuzuari të lirohet nga aktakuza.

Përgjigje në ankesë të Prokurorisë ka paraqitur, i akuzuari H.S., me propozim që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet, ndërsa të refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

Përgjigje në ankesë të Prokurorisë kanë paraqitur, i akuzuari N.H., me propozim që aktgjykimi i ankimuar të vërtetohet, ndërsa të refuzohet si e pa bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore në Mitrovicë.

Prokuroria e Apelit me parashtresën PPA/I.nr.72/18 të datës 23.02.2018, ka propozuar që të aprovohet si e bazuar ankesa e Prokurorisë Themelore-DKR në Mitrovicë, kurse aktgjykimi

lirues për të akuzuarit H.S., V.J. dhe N.H. të anulohet, çështja të kthehet në rivendosje, ndërsa për të akuzuarit H.G. dhe L.K. aktgjykimi i ankimuar të ndryshohet dhe të njëjtëve t'iu shqiptohen dënime më të ashpra. Ndërsa të refuzohen përgjigjet në ankesën e Prokurorisë, e të akuzuarve H.S. dhe N.H., si të pabazuara.

Gjykata e Apelit, konform nenit 390 par.1 të KPPK-së, mbajti seancën e kolegjit për të cilën nuk u njoftuan Prokurori i Apelit, të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre, meqenëse të akuzuarve H.G. dhe L.K. iu është shqiptuar dënim me gjobë, kurse të akuzuarit H.S. dhe N.H. janë liruar nga akuza.

Gjykata e Apelit shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, ankesën e Prokurorisë Themelore DKR në Mitrovicë dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve H.G. dhe L.K. dhe përgjigjen në ankesën e prokurorisë të akuzuarve H.S. dhe N.H., analizoj edhe shkresat tjera të lëndës, gjeti se :

Ankesa e Prokurorisë Themelore DKR në Mitrovicë dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve, janë të pa bazuara.

Mbrojtësi i të akuzuarit L.K. pretendon, se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë në shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, se dispozitivi i aktgjykimit është në kundërshtim me arsyetimin dhe provave të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, se gjykata e shkallës së parë, nuk ka paraqitur në mënyrë të qartë dhe të plotë se cilat fakte i ka konsideruar të vërtetuara apo të pa vërtetuara dhe nuk ka saktësuar provat kundërthënëse, se nuk është argumentuar se i akuzuari L. ka pasur për qëllim të përfitimit pasuror për vete apo personat tjerë, nuk ka të dëmtuar, se kryetari i komunës ka deklaruar se nuk është dëmtuar Komuna e Skenderajt por ka pasur rritje të të hyrave.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit L.K. se aktgjykimi i ankimuar është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, nuk qëndrojnë, e as shkelje të cilat kjo gjykatë i shikon edhe sipas detyrës zyrtare, dispozitivi i aktgjykimit është i qartë dhe i kuptueshëm, nuk ka kundërthënie ndërmjet asaj që paraqitet në arsyetimin e aktgjykimit dhe përmbajtjes së shkresave të lëndës të cilat janë administruar gjatë shqyrtimit gjyqësor, kurse sa i për ketë pretendimit të mbrojtësit të akuzuarit, se i mbrojturi i tij nuk ka pasur përfitim pasuror për vete, e as personat tjerë, se nuk e ka dëmtuar Komunën e Skenderajit por ka pasur rritje të hyrave, nuk qëndrojnë, se i akuzuari ka tejkalluar kompetencat duke vepruar në kundërshtim me ligjin me nr. 03/L-226, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme personave privat pa miratimin e Kuvendit Komunal.

Mbrojtësit e të akuzuarve H.G. dhe L.K., pretendojnë se gjykata e shkallës së parë, gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike kur të akuzuarit i ka shpallur fajtorë për veprën penale keqpërdorim i detyrës apo autoritetit zyrtar sipas nenit 422 par. 1 lidhur me nenin 81 të KPRK-së, se të akuzuarit nuk i kanë tejkalluar kompetencat e tyre zyrtare me qëllim të përfitimit të çfarëdo dobie pasurie për vete apo për personin tjetër, se në rastin konkret të akuzuarit kanë dhënë në shfrytëzim të përkohshëm lokalet dhe tokat e Komunës, e jo në shfrytëzim afatshkurtër,

se qytetarët për marrjen në shfrytëzim të përkohshëm të tokës në territorin e Komunës së Skenderajit i drejtohen Drejtorisë për Xheodezi Kadastër dhe Pronësi, e që rregullorja për taksa dhe tarifa, ngarkesa dhe gjoha për vitin 2014 parasheh çështjen e shfrytëzimit të përkohshëm të tokës shoqërore, e të akuzuarit kanë vepruar në harmoni me rregulloren që ka qenë në fuqi e nënshkruar nga kryesuesi i Komunës së Skenderajit me datë 02.06.2014, në nenin 10 të rregullores janë paraparë kompetencat e Drejtorisë për Xheodezi Kadastër dhe Pronë, në bazë të së cilës kjo drejtori lidhë kontrata për dhënien me qira të tokës ndërtimore. Ashtu që edhe Komuna e Skenderajit nuk ka formuar ndonjë komision për shkelje, sepse nuk ka qenë e dëmtuar në këtë rast, por një veprim i tillë i ka mundësuar rritjen e vlerës së tokës dhe veprimet e të akuzuarve në këtë rast kanë qenë në harmoni të plotë me rregulloren e brendshme të Komunës me nr.110/83 për Organizim dhe Përgjegjësi të Organeve të Administratës komunale të datës 01.12.2011. Lidhur me këtë rregullore Ministria e Administratës e Pushtetit Lokal si organi më i lartë mbikëqyrës nuk ka dhënë asnjë vërejtje por ka konsideruar se këto rregullore janë në pajtim me ligjin, ku edhe të akuzuarit kanë vepruar duke u mbështetur në to dhe shumica e këtyre pronave kanë qenë të dhënë në shfrytëzim edhe më herët por vetëm është bërë ndërrimi i titullarëve dhe të akuzuarit nuk kanë penguar asnjë projekt publik me interes strategjik të planifikuar për Komunën, se këto prona kanë qenë të lira, nuk ka dashje dhe qëllimi të akuzuarve për veprën penale keqpërdorimi detyrës zyrtare, se edhe nënkryetari i komunës F.N. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se komuna në këtë rast nuk ka qenë e dëmtuar sepse paratë e përfituara nga qiraja janë derdhur në buxhetin e Komunës.

Gjykata e Apelit ka vlerësuar se gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë nga gjykata e shkallës së parë, se nuk është kontestuese se i akuzuari H.G. në periudhën kohore 17.11.2010 deri në 08.07.2013 ka qenë në cilësi të drejtorit në Drejtorinë për Xheodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajit, kurse i akuzuari L.K. ka vazhduar si drejtor në periudhën kohore 31.03.2014 deri në deri në 15.02. 2015, të cilët duke e shfrytëzuar pozitën e tyre zyrtare i kanë tejkaluar kompetencat zyrtare dhe kanë nënshkruar kontrata për dhënien me qira të palujtshmërive publike në shfrytëzim personave privat, pa i përfillur procedurat ligjore. Sepse sipas ligjit me nr. 03/L-226 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme, parashihen procedurat të cilat duhet ti ndërmer Kuvendi i Komunës; të themeloj komisionin e posaçëm në përbërje të përfaqësuesve të ekzekutivit të komunës të cilët i vlerësojnë ofertat dhe i propozojnë kuvendit listën e ngushtë së paku prej tre personave për marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme. Kuvendi i Komunës merr vendim paraprak për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme me shumicë të votave, kurse të akuzuarit nuk kanë pasur të drejtë të nënshkruajnë kontrata e cekura në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar. Se Ligji nr. 04/L-144 neni 5 par. 1 përcakton procedurën për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme, e cila realizohet përmes konkurrencës së hapur publike nga ana e Komunës. E në rastin konkret asnjëri nga të akuzuarit me rastin e dhënies se lokaleve dhe tokave në shfrytëzim afatshkurtër personave privat nuk i kanë respektuar ligjet e cekura më lartë, e të cilat kanë qenë të obligueshme. Ashtu që në të gjitha kontratat e nënshkruar nga ana e të akuzuarve H.G. dhe L.K. nuk është caktuar afati se deri kur mund të shfrytëzohen lokalet dhe tokat e dhëna me qira dhe nuk mund të konsideron se janë dhënë në shfrytëzim për afat një

vjeçar apo vit fiskal, se të akuzuarit kanë qenë të vetëdijshëm se nuk kanë lidhë kontrata një vjeçare dhe i kanë lidhur pa miratimin e Kuvendit Komunal në Skenderaj.

Në këtë mënyrë të akuzuarit i kanë tejkualuar autorizimet e tyre zyrtare në cilësi të drejtorëve në Drejtorinë për Xheodezi Kadastër dhe Pronë në Komunën e Skenderajit, duke iu krijuar favore personave të shumtë të cekur në dispozitiv të aktgjykimit të ankimuar, me qëllim që të tjerët të përfitojnë dobi të kundërligjshme pasurore, në kundërshtim me Ligjin nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të komunës, personave privat po i përfillur dispozitat ligjore.

Gjykata e Apelit, gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë e aprovon, sepse e njëjta është e bazuar në provat që i ka administruar gjykata e shkallës së parë e që gjinden në shkresat e lëndës, si Ligjin nr.03/L-226 për dhënien në shfrytëzim pronën e paluajtshme të komunës, kontratat për dhënien me qira të pronave e paluajtshme personave të ndryshëm, pa i respektuar procedurat ligjore.

Nga arsyet që u thanë më lartë, kjo gjykatë gjen se janë të pabazuara pretendimet e mbrojtësve të akuzuarve, se me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar, se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vërtetuar gjendje faktike, e cila është e pranueshme edhe për këtë gjykatë.

Mbrojtësi i të akuzuarit H.G., pretendon se si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, ka ardhur deri te zbatimi i gabuar i së drejtës materiale, se me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari e ka kryer veprën penale, keqpërdorim i pozitës apo autoriteti zyrtar nga neni 422 par.1 të KPRK-së, për të cilën veprë penale e ka shpallur fajtor.

Gjykata e Apelit duke vlerësuar pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit se është shkelur ligji penal në dëm të akuzuarit, konstaton se pretendimet ankimore të mbrojtësit të akuzuarit, janë të pa bazuara, se me provat e administruara është vërtetuar në mënyrë të pa dyshimtë fajësia e të akuzuarit, se në veprimet e të akuzuarit formohen elementet e veprës penale nga neni 422 par. lidhur me nenin 81 të KPRK-së.

Prokuroria Themelore ne Mitrovicë, pretendon se gjykata e shkallës së parë nuk i ka vlerësuar drejtë te gjitha rrethanat, me rastin e caktimit të llojit dhe lartësisë së dënimit ndaj të akuzuarve H.G. dhe L.K., se është dashur ti vlerësoj edhe rrethanat rënduese, si shkallën e përgjegjësisë penale të akuzuarve, dashjen dhe rrethanat nën të cilat janë kryer veprat penale, se veprat e tilla janë në rritje, ka propozuar që të akuzuarve të ju shqiptoj një dënim më ashpër, me të cilin nuk mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe të i parandaloj të tjerët në kryerjen e veprave penale.

Duke e shqyrtuar çështjen përkitazi me vendimin për dënimin, sipas ankesës se mbrojtësit të akuzuarit H.G., kjo gjykatë e vlerëson edhe për të akuzuarin L.K., se gjykata e shkallës së parë drejt i ka vlerësuar rrethana që kanë ndikuar në llojit dhe lartësisë se dënimit. Gjykata e Apelit gjenë, se gjykata e shkallës së parë, me rastin e caktimit të dënimit, ka pasur parasysh rrethanat që kanë ndikuar në llojin dhe lartësinë e dënimit, si rrethana lehtësuese ka marrë, për të dy të

akuzuari se më parë nuk kanë qenë të dënuar, se janë familjar, i akuzuari H., baba i katër fëmijëve, të cilat rrethana i aprovon edhe kjo gjykatë, kurse si rrethana rënduese nuk ka gjetur, se në rastin konkret dënimet e shqiptuar me burgim në kohëzgjatje prej nga 6 (gjashtë) muaj, e të zëvendësuar me pëlqimin e të akuzuarve me dënim me gjobë në shumë prej nga 1800 euro, i aprovon edhe kjo gjykatë, kurse Prokuroria në ankesë, nuk ka dhënë rrethana konkrete rënduese të cilat kishin me ndikuar në ashpërsimin e dënimit, andaj pretendimet e prokurorisë në ankesë se të akuzuarve duhet shqiptuar dënim më të ashpër dhe pretendimet e mbrojtësit të akuzuarit se dënimi i shqiptuar është i ashpër, janë të pa bazuara, se ky dënim është në shërbim të preventivës së përgjithshme, është në funksion të parandalimit të kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëj rehabilitimin dhe të ndikoj edhe në personat tjerë që mos të kryejnë vepra penale, me të cilin dënimin ndaj të akuzuarve do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPK.

Sa i përketë pjesës liruese të aktgjykimit, kjo gjykatë vlerëson se gjykata e shkallës së parë nuk ka gjetur prova se të akuzuarit H.S., V.J. dhe N.H. kanë kryer veprën penale Keqpërdorimi i pozitës zyrtare nga neni 422 par.1 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, andaj të akuzuarit me të drejtë i ka liruar nga aktakuza në mungesë të provave.

Pretendimet ankimore të paraqitur nga PTH në Mitrovicë lidhur me pjesën liruese të aktgjykimit, janë të pa bazuara, se me aktgjykimin e ankimuar gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të gabuar dhe jo të drejtë, kur të akuzuarit i ka liruar nga akuzat, se gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar çdo provë veç e veç, e pastaj të gjitha së bashku duke dhënë arsye, se pse nuk është provuar se të akuzuarit e kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Gjykata e Apelit vlerëson se, të akuzuarit H.S., V.J. dhe N.H., janë emëruar anëtarë të komisionit për hapjen ofertave nga kryetari i komunës së Skenderajit, kurse nuk kanë pasur njohuri për procedurat përkatëse administrative, pasi që në vendimi është dashur të precizohet se çfarë detyre kanë anëtarët e komisionit kur bëjnë hapjen e afërtave, të akuzuarit në bazë të këtij vendimi kanë përfunduar punën e tyre ku e dhe kanë përpiluar raportin në bazë të dokumentacionit të prezantuar, se të akuzuarit kanë deklaruar se për herë të parë kanë marrë pjesë në një komision të tillë dhe nuk kanë pasur njohuri për të drejta dhe detyrat e tyre, atëherë gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vepruar kur ka konstatuar se në veprimet e të akuzuarve nuk ekzistojnë elementet e veprës penale për të cilën janë akuzuar, se kjo vepër penale kryhet me dashje të drejtpërdrejtë, që të akuzuarit të kenë qenë në dijeni, se po i tejkalojnë kompetencat e tyre, në rastin konkret të akuzuarit i kanë tejkaluar kompetencat e tyre zyrtare por nuk kanë qenë në dijeni për këtë tejkalim, andaj pretendimet ankimore të prokurorisë nuk janë të bazuara, gjykata e shkallës së parë drejtë dhe në mënyrë të plotë e ka vërtetuar gjendjen faktike dhe në mënyrë të ligjshme ka bërë vlerësimin e provave, ka nxjerrë konkluzione të drejta dhe të ligjshme përkitazi me veprën penale për të cilën i ka liruar nga akuzat të akuzuarit.

Si është thënë më lartë gjendjen faktike të vërtetuar nga gjykata e shkallës së parë e aprovon dhe kjo gjykatë, meqenëse me provat e administruara nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar, prandaj gjykata e shkallës së parë drejt ka

zbatuar ligjin penal kur të akuzuarit i ka liruar nga akuza, meqenëse me provat e administruara nuk është vërtetuar se kanë kryer veprën penale për të cilën janë akuzuar.

Nga çka u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimit në bazë të nenit 401të KPPK-së.

PAKR.nr. 68/2018 datë 6.04.2018

Procesmbajtësi

Antarët e kolegjit

Kryetarja e kolegjit

Perparim Zeka

1. Have Haliti

Tonka Berishaj

2. Fillim Skoro